



Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

**RAPORTI VJETOR I INSPEKTIMEVE
2020**

PËRMBAJTJA

• PËRMBLEDHJE

• HYRJE

• QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

1. SEKTORI I INSPEKTIMIT

- 1.1 Sektori i Koordinimit dhe monitorimit të Inspektimit (ISHSH qendror)
- 1.2 Sektori i Inspektimit Sanitar (ISHSH rajonal)
- 1.3 Sektori i Inspektimeve të tjera shëndetësore (ISHSH rajonal)
- 1.4 Inspektime dhe ri-inspektime
- 1.5 Masa Administrative.
- 1.6 Inspektimet e kryera gjatë vitit 2020 sipas fushave të inspektimeve.

2. SEKTORI JURIDIK

- 2.1 Sektori Juridik dhe i Hartimit të Proçedurave të Inspektimit (ISHSH qendror)
- 2.2 Sektori Juridik (ISHSH rajonal)

3. SEKTORI I FINANCËS DHE I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- 3.1 Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse (ISHSH qendror)
- 3.2 Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse (ISHSH rajonal)

4. ARRITJET E INSPEKTORATIT SHTETËROR

5. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

6. TREGUESIT E EFEKTIVITETIT TË ISHSH GJATË VITIT 2020

• SHTOJCA

•

- BAZA LIGJORE E NXJERRE PER PERBALLIMIN E COVID-19.
- BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË ISHSH

INSPEKTORATI SHETETËROR SHËNDETËSOR

RAPORTI VJETOR 2020

PËRMBLEDHJE

Materiali në vijim është një analizë e hollësishme e punës dhe aktivitetit të Inspektoratit Shetëror Shëndetësor (ISHSH) gjatë vitit 2020.

Shpërthimi aktual i COVID-19, i cili filloi në Dhjetor 2020, paraqet një sfidë të konsiderueshme për Shqipërinë, si dhe për të gjithë botën. Sëmundja e shkaktuar nga virusi i ri u etiketua COVID-19 dhe OBSH shpalli shpërthimin e saj “Urgjencë e Shëndetit Publik të Rëndësisë Ndërkombëtare” (PHEIC) në 30 Janar 2020”. *“Duke mos qenë asnjëherë i ekspozuar ndaj këtij virusi më parë dhe mungesa e vaksinave dhe ilaçeve specifike për parandalimin dhe trajtimin e tij, ne të gjithë jemi të ekspozuar ndaj kësaj sëmundje e cila kërcënon të përhapet globalisht, duke përfshirë edhe vendin tone”.*

Pandemia e shkaktuar nga SARS-CoV-2 përbën një sfidë globale jo vetëm për faktin se është një virus i ri dhe i panjohur, por edhe për nga natyra e tij dhe fakti se shkakton sëmundje të rëndë tek njerëzit dhe përhapet potencialisht lehtësisht edhe ndërmjet personave që nuk shfaqin simptoma. Rritja e shpejtë e numrit të të infektuarve dhe të atyre që shfaqin forma të rënda të sëmundjes COVID-19 e për pasojë edhe rritja e numrit të të vdekurve, ka detyruar qeveritë në të gjithë botën të marrin masa që variojnë nga rritja e kapaciteteve spitalore e deri tek vendimet drastike që limitojnë aktivitetet e që kanë për qëllim ngadalësimin e shpërhapjes së virusit. Në këto kushte dhe duke njohur natyrën e koronavirusit të ri, ndalimi i plotë i përhapjes së tij është virtualisht i paarrtshëm. Për këtë arsye, qëllimi është rrafshimi i kurbës së epidemisë, e cila në mungesë të këtyre masave shtrënguese do të kishte një pjerrtësi të madhe, që do të përkthehej në një shkallë të lartë infektimi e, për pasojë, mbingarkim të sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe rritje të fataliteteve.

E gjithë përballja me epideminë e COVID-19 apo SARS-CoV-2 deri tani në Shqipëri është kryer duke u mbështetur dhe bazuar me përpikmëri në planin e parapërgatitjes ndaj pandemisë “Plani i Veprimit COVID-19” i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i cili ka patur për qëllim orientimin e veprimeve dhe masave të marra sipas skenarëve të hartuar në bazë të modeleve epidemiologjike. Falë masave të marra në kohë nga Qeveria shqiptare dhe parashikimit e ndjekjes rigoroze të skenarëve të planit parapërgatitor, situata aktuale paraqitet me një tablo të butë të epidemisë si dhe me një përballje të mirë të sistemit shëndetësor kundrejt rasteve të COVID-19.

Të gjitha udhëzimet dhe masat kufizuese të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale patën si qëllim ruajtjen e shëndetit publik të popullatës, fitimin e njohurive epidemiologjike në lidhje me virusin, uljen e përhapjes së COVID-19, të sëmundjeve shoqëruese të saj, uljen e kurbës së infeksionit si dhe zvogëlimin e kontakteve nëpërmjet distancimit social.

Masat e marra ndikuan ndjeshëm në zvogëlimin e përhapjes së virusit, bazuar kjo dhe në treguesit e deritanishëm, megjithatë, qëllimi i rishikimit tashmë të masave nuk është më për të ndaluar pandeminë, por për ta ngadalësuar atë akoma më tepër.

Menaxhimi strategjik i sistemit shëndetësor në periudhën COVID-19 në Shqipëri, bazuar në vendimet strategjike, politikat e reja shëndetësore, u realizua nëpërmjet zbatimit të planit të veprimit kundër COVID-19, të cilat lidhen me:

- Ngritjen e Task Forcës, për parandalimin e infeksionit të përhapur nga Koronavirusi.
- Marrjen në kohë të masave higjieno sanitare, për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute, përfshire dhe COVID - 19 në sistemin arsimor si, kopshte, çerdhe, shkolla, univeristete etj.
- Miratimin e protokolleve dhe algoritmeve për parandalimin e sëmundjes COVID-19 në Shqipëri.
- Miratimin e listës së sëmundjeve infektive të detyrueshme për t'u raportuar nga institucionet shëndetësore, publike, private në Shqipëri.
- Ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të karantinës në mjedise të përcaktuara.
- Mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike si dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura në Shqipëri.
- Kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve në spitale.
- Vetëkarantinimin e personave që hynë në territorin e Shqipërisë nga zonat e izoluara të Italisë apo dhe të rajoneve të tjera.
- Mbrojtjen dhe ruajtjen e të moshuarve duke parandaluar vizitat në shtëpitë e kujdesit të të moshuarve.
- Shmangien e kontakteve fizike me të tjerët për pensionistët-popullatën mbi moshën 65 vjeç, me qëllim kufizimin dhe respektimin e distancimit social.
- Marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga COVID-19, të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- Ndërprerjen e udhëtimeve brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë (transport rrugor, ajror, detar dhe publik) me qëllim kufizimin e lëvizjes së popullatës.
- Ndalimin e tubimeve publike me më shumë se pesëdhjetë persona.
- Ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”.
- Mbylljen e veprimtarisë së çerdheve, kopshteve, arsimit shkollor me qëllim kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ISHSH, është institucioni kryesor i ngarkuar për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, masa të cilat rrjedhin prej Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Më 1 shkurt 2020, në të 31 pikat e kalimit kufitar, inspektorët e ISHSH vendosën posterat paralajmërues për masat mbrojtëse që duheshin respektuar në lidhje me mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Njësia e Inspektimit Shëndetësor në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas filloi zbatimin e masave shtesë me monitorimin dhe matjen e temperaturës së të gjithë pasagjerëve që hynin në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në pikat e kalimit kufitar detar me Italinë dhe Greqinë, inspektorët e ISHSH në bashkëpunim me NJVKSH kanë kryer kontrole të pandërprera në portet e Durrësit, Vlorës, Sarandës, për matjen e temperaturës të pasagjerëve dhe të gjithë drejtuesve të mjeteve të transportit detar dhe plotësimin e Formularit të Vlerësimit dhe Investigimit për udhëtarët që hyjnë në Shqipëri.

Puna dhe aktiviteti i ISHSH gjatë vitit 2020 është kryer duke jetuar me pandeminë e COVID-19 dhe bazuar në përvojën më të mirë të institucionit tonë në vite gjithmonë duke pasur në mendje krijimin dhe funksionimin e një institucioni që i përgjigjet kërkesave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe është në shërbim të tyre. Përveç detyrave funksionale, trupa inspektuese e ISHSH ka kryer kontrole të vazhdueshme për zbatimin e protokolleve të masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Strukturat e ISHSH gjatë vitit 2020 kryen 403 908 inspektime, ri-inspektime dhe monitorime në të gjithë territorin e vendit në respektim të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik dhe në zbatimin e Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe të gjitha akteve normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19.

Në momentet kryesore të inspektimeve, ri-inspektimeve dhe monitorimeve të vitit 2020 mund të përmenden:

- Monitorime dhe inspektime të vazhdueshme për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, masa të cilat rrjedhin prej Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19.
- Monitorime të përditshme të kushteve higjieno sanitare dhe shëndetësore në qendrat e akomodimit të qytetarëve të dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2020, monitorimi i ujit të pijshëm, monitorim i nyjeve hidrosanitare në subjektet me grumbullime të mëdha për parandalimin e sëmundjeve infektive, largimi i mbetjeve urbane, dezinfektimi i zonave pas largimit të inerteve dhe dokumentacioni shëndetësor dhe higjieno sanitar i personelit të shërbimit.
- Inspektimi i shërbimeve shëndetësore parësore jo-publike (qendër mjekësore, kabinet mjekësor, shërbim laboratorik dhe kabinetet imazherike).
- Inspektimi i klinikave dhe laboratorëve stomatologjikë publike dhe jo- publike.
- Inspektimi i spitaleve publike dhe jo publike.
- Inspektim për firmat prodhuese, importuese dhe tregtuese për zbatimin e Ligjit nr. 9942 datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar.
- Inspektime për akreditimin e institucioneve shëndetësore.
- Inspektime në shtëpitë e të moshuarve publike dhe jo publike, institucionet rezidenciale publike të kujdesit për fëmijë, qendrat rezidenciale për fëmijë jo-publike.
- Inspektime për zbatimin e ligjit nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar.
- Inspektime për zbatimin e ligjit nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”, i ndryshuar.
- Inspektim për firmat prodhuese, importuese dhe tregtuese për zbatimin e Ligjit nr. 8528 datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”, i ndryshuar.
- Inspektimi higjieno-sanitar i institucioneve arsimore parashkollore universitare, mencave dhe konvikteve në funksion të këtyre institucioneve.
- Inspektim për institucionet e ekzekutimit të dënimeve të veprave penale, paraburgimit dhe komisariatet e policisë.

- Inspektimi ndërmarrjeve për kujdesin dhe sigurinë e shëndetit në punë.
- Inspektimi i subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Inspektimet për zbatimin e ligjit 26/2017 “Për Produktet Kozmetike”.

INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR

RAPORTI VJETOR 2020

HYRJE

Ky raport hartohet sipas kërkesave të ligjit Nr. 10433, dt. 16. 06. 2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Urdhërit Nr. 7, dt. 19. 02. 2015 të Inspektoratit Qendror dhe përmbledh aktivitetin dhe arritjet e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor gjatë vitit 2020.

Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është: “Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik”.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor në përmbushje të detyrimeve ligjore, synon arritjen e këtyre objektivave:

- Të rrisë sigurinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ofrojë transparencë dhe metoda sa më bashkëkohore për kryerjen e kontrolleve nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga një staf i përgatitur inspektorësh.
- Të krijojë një sistem të brendshëm alarmi të shpejtë për të arritur në një gjurmueshmëri të plotë të të gjitha produkteve dhe mallrave brenda fushës që ai mbulon.
- Të ndërgjegjësojë subjektet e inspektimit për masat që duhen marrë për përmirësimin e aktivitetit të tyre në kuadër të legjislacionit në fuqi në lidhje me sigurinë shëndetësore, duke synuar plotësimin e kushteve që kërkojnë të arrihen për integrimin European.
- Të mbrojë konsumatorët shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet në fushën e shëndetësisë.
- Të ndërgjegjësojë operatorët e biznesit shqiptarë dhe konsumatorëve lidhur me praktikën e mira të higjienës shëndetësore që duhet të aplikohen në të gjithë fushën e aktivitetit të ISHSH.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor në përmbushje të detyrimeve ligjore, kryen:

- Bashkërendimin dhe koordinimin efikas të veprimtarisë në fushat të cilat janë në kompetencë të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, duke përjashtuar inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike;
- Sigurimin dhe unifikimin e praktikave më të mira të inspektimit, në shkallë vendi;
- Informimin e publikut për veprimtarinë e inspektimit;
- Dhënien e mbështetjes teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit;
- Përgatitjen e programit dhe raportit vjetor të inspektimit.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka objekt të punës së tij:

- Identifikimin e rreziqeve në të gjithë vendin dhe kërcënimet nga aktivitetet e paligjshme.

- Kryerjen e inspektimeve në kohë dhe me saktësi si dhe ato të përbashkëta sipas programit vjetor.
- Zhvillimin e zgjidhjeve inovative për të zbutur rreziqet dhe kërcënimet.
- Dhënien e informacionit në kohë dhe cilësi për vendimmarrësit.
- Vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe përmirësimeve që mbështesin zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së ISHSH.

ISHSH organizohet në dy nivele: Në nivel qendror dhe atë rajonal për çdo qark të vendit.

ISHSH qendror drejtohet nga Kryeinspektori. Kryeinspektori është titullari i institucionit, i cili në kuadër të funksioneve dhe detyrave të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHSH.

ISHSH në nivel qendror përbëhet nga:

- Kryeinspektori;
- Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit;
- Sektori Juridik dhe i Hartimit të Procedurave të Inspektimit;
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.



ISHSH rajonale drejtohen nga kryeinspektorët rajonalë. Kryeinspektori rajonal përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretët në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin e funksionimit si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së degës së tij.

ISHSH në nivel rajonal përbëhet nga:

- Titullari i degës Rajonale/Kryeinspektor;
- Sektori i Inspektimit Sanitar;
- Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore;
- Sektori Juridik;
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.



INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR

RAPORTI VJETOR 2020

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

QËLLIMI

- Identifikimi i rreziqeve në të gjithë vendin dhe kërcënimet nga aktivitetet e që përbëjnë rrezik për shëndetin publik.
- Kryerjen e inspektimeve në kohë dhe me saktësi, si dhe atyre të përbashkëta sipas programimit vjetor;
- Dhënia e informacionit në kohë dhe cilësi për vendimmarrësit;
- Vlerësimi i kontrolleve të brendshme dhe përmirësime që mbështesin zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së ISHSH.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë raport bazohet në programin e inspektimit i cili është instrumenti që përdor inspektorati shtetëror për planifikimin e akteve të inspektimit, me qëllim kontrollin për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

Raporti është bazuar në aktet e inspektimit, raportet dhe memot përfundimtare të përgatitura në përfundim të cdo inspektimi.

1. SEKTORI I INSPEKTIMIT

- 1.1 Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit (ISHSH qendror)
- 1.2 Sektori i Inspektimit Sanitar (ISHSH rajonal)
- 1.3 Sektori i Inspektimeve të tjera shëndetësore (ISHSH rajonal)
- 1.4 Inspektime, ri-inspektime dhe monitorime.
- 1.5 Masa Administrative
- 1.6 Inspektimet e kryera gjatë vitit 2020 sipas fushave të inspektimit.

1.1 Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit (ISHSH qendror)

Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit është struktura përgjegjëse për koordinimin, inspektimin dhe raportimin e realizimit të Programit të Inspektimit zyrtar të kryer në të gjithë vendin të përcaktuar në vijim të rregullores. Sektori bashkëpunon me degët rajonale, për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e shëndetësisë si dhe me Procedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH, Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore. Inspektorët e Sektorit të Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit kryejnë detyrat e tyre në mbështetje të nenit 119 të Kushtetutës së Shqipërisë, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të nenit 29, të pikës 2 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 27.03.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, Urdhërit Nr. 163, datë 19.05.2014 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, Urdhër Nr. 2, datë 16.01.2016 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 163, datë 19.05.2014 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”.

Sektori i Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit përbëhet nga:

- Përgjegjësi i sektorit
- 1 (një) Inspektor për inspektimin sanitar;
- 1 (një) Inspektor për inspektimin ambulator;
- 1 (një) Inspektor për inspektimin e burimit të rrezatimit;
- 1 (një) Inspektor për inspektimin stomatologjik;
- 1 (një) Inspektor për inspektimin spitalor;
- 4 (katër) Inspektorë për inspektime të tjera.

Inspektorët e Sektorit të Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit:

- Hartojnë programet e inspektimit vjetorë dhe mujorë për fushën specifike që mbulon cdo inspektor dhe ia paraqesin përgjegjësit të sektorit për miratim.
- Kontrollojnë dhe përmirësojnë planet afatshkurtëra që paraqesin inspektoriatet rajonale dhe ia paraqesin përgjegjësit të sektorit të koordinimit dhe monitorimit të inspektimeve për miratim.
- Monitorojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë inspektuese të inspektorateve rajonale, përmbushjen e detyrave sipas planit të punës të miratuar nga ISHSH në nivel qendror.

- Përgatitin raportin për programin vjetor dhe mujor të inspektimeve të kryera nga degët rajonale dhe ja paraqesin përgjegjësit të sektorit të koordinimit dhe monitorimit të inspektimeve.
- Kryejnë inspektime të drejtpërdrejta ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit dhe atyre që kryejnë veprimtari me rrezikshmëri të lartë për shëndetin.
- Japin asistencë teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit.
- Sigurojnë praktika të unifikuara të inspektimit në shkallë vendi.
- Mbikqyrin zbatimin e ligjit të inspektimit për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit.

1.2 Sektori i Inspektimit Sanitar (ISHSH rajonal)

Sektori i Inspektimit Sanitar është struktura përgjegjëse për inspektimin dhe realizimin e programit të inspektimit vjetor të hartuar nga ISHSH Qendror. Sektori bashkëpunon me sektorët e tjerë për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën sanitare si dhe me procedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH Rajonal, Sektori i Inspektimit Sanitar ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore.

Sektori i Inspektimit Sanitar përbëhet nga:

- Përgjegjësi i sektorit
- Inspektorë sanitarë

1.3 Sektori i Inspektimeve të tjera shëndetësore (ISHSH rajonal)

Sektori i Inspektimeve të tjera shëndetësore është struktura përgjegjëse për inspektimin dhe realizimin e programit të inspektimit vjetor të hartuar nga ISHSH Qendror. Sektori bashkëpunon me sektorët e tjerë për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën sanitare si dhe me procedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH Rajonal, Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore.

Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore përbëhet nga:

- Përgjegjësi i sektorit
- Inspektorë stomatolog
- Inspektorë për institucionet shëndetësore
- Inspektorë për inspektime të tjera

Inspektorët e Sektorit të Inspektimit Sanitar dhe Inspektimeve të tjera Shëndetësore:

- Kryejnë inspektime, sipas përcaktimeve në programimin e inspektimit.
- Zbatojnë procedurat dhe hapat e inspektimit sipas ligjit nr 10 433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve e akteve të tjera nën ligjore në fushën e shëndetit publik që janë në fuqi.
- Kryejnë detyrat që u ngarkohen konform legjislacionit në fuqi, në kohë dhe me cilësi si dhe duke respektuar me rigorizitet kërkesat dhe parimet kryesore si objektiviteti, korrektësia, konfidencialiteti, profesionalizmi etj.

- Gjatë ushtrimit të detyrës, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe jep informacion vetëm në bazë dhe brenda kufijve të ligjit dhe rregullores të institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit të inspektimit apo personave të tjerë.
- Gjatë ushtrimit të kontrollit, janë të detyruar të zbatojnë të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi si dhe akte të tjera administrative që janë në funksion të veprimtarisë në fushën e inspektimeve.
- Mbajnë lidhje të vazhdueshme me përgjegjësin e sektorit dhe i njofton ata për ecurinë dhe problemet që evidentohen gjatë ushtrimit të inspektimit dhe për masat e ndërhyrjet që kërkohen në proces në varësi të këtyre problemeve.
- I kërkojnë përgjegjësit të sektorit zgjatjen e afatit të programuar për përfundimin e inspektimit, kur e gjykon të nevojshme dhe e argumenton atë me volum më të madh pune nga parashikimi apo për probleme të ndryshme të dala gjatë procesit të inspektimit.
- Bazuar në rezultatet dhe dokumentacionin e inspektimit, hartojnë relacion inspektimi, ku pasqyrohen përfundimet e arritura nga inspektimi.
- Marrin dokumenta për sigurimin e provave dhe fotokopje të vërtetuara me origjinalin të dokumentave për veprimet që kanë lidhje me inspektimin që ushtrohet.
- Në përfundim të të gjithë fazave dhe procedurave të kontrollit të çdo subjekti plotësojnë dosjen e kontrollit në inventarin e së cilës evidentohet dhe administratohet i gjithë dokumentacioni i kontrollit sipas kërkesave të përcaktuara.
- Dorëzojnë tek përgjegjësi i sektorit ose një punonjësi të autorizuar prej tij, dosjen e plotësuar si më sipër dhe me shkresën evidentuese për çdo inspektim të përfunduar.
- Mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore, administrative, sipas rastit, për vërtetësinë dhe saktësinë e rezultateve të punës së tij inspektuese.
- Inspektorët që ngarkohen me shqyrtimin e denoncimeve duhet të marrin cdo informacion dhe dokumentacion të nevojshëm nga përgjegjësi i sektorit dhe për përfundimet e procesit të njoftojnë organet përkatëse dhe subjektin denoncues.
- Marrin masë administrative në rastet e konstatimit të shkejeve ligjore së bashku me inspektorët e tjerë të grupit.
- Përgjigjen para përgjegjësit të Sektorit për realizimin e detyrave të ngarkuara.
- Mbajnë përgjegjësi për bazën materiale të praktikave inspektuese.

1.4 Inspektime dhe ri-inspektime

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor kreu 403 908 inspektime, ri-inspektime dhe monitorime në të gjithë territorin e vendit gjatë vitit 2020. E detajuar:

- 403 908 Inspektime, ri-inspektime dhe monitorime.
- 9 989 Inspektime.
- 245 Ri-inspektime.
- 393 674 Monitorime.
- Gjatë vitit 2020 janë pajisur me Akt Miratim higjieno sanitar 1117 subjekte.

Të gjitha inspektimet dhe ri-inspektimet janë kryer on line nëpërmjet sistemit e-inspection. Kryerja e inspektimeve nëpërmjet portalit e-inspection si dhe respektimit të rregullores së nxjerrë në zbatim të këtij të fundit ka si objekt përcaktimin e rregullave për kryerjen e inspektimeve, bazuar në një procedurë administrative të rregullt ligjore me qëllim rritjen e efektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe shmangies së korrupsionit në fushën e veprimtarisë së inspektimeve që mbulon ISHSH.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka qenë gjatë vitit 2020 dhe vazhdon të jetë pjesë e Task Forcës së krijuar në bazë të Vendimit të Komitetit të Emergjencave Civile nr. 15, datë 25.4.2020 “Për krijimin e Task-Forcës për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, të drejtuar nga Kryeministri Edi Rama, së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Inspektoratin e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore, Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Task Forca ushtron kontrolle në terren me qëllim garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në njësitë tregtare të lejuara të ushtrojnë aktivitetin për periudhën e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Drejtimi i Aktivitetit të Task-Forcës dhe Njesisë Operacionale i është ngarkuar zyra të Prefekteve në qarqe. Të gjitha monitorimet e Task Forcës janë realizuar nëpërmjet platformës Google Forms, ku janë vendosur Protokollat përkatëse sipas publikimit të ketyre të fundit në e-albania.

Në rastet kur subjektet janë gjetur në shkelje, inspektimi dhe masa administrative është vendosur nëpërmjet sistemit e-inspection, sipas procedurave inspektuese standarte, të unifikuara, me pajisjen portabël “tablet”.

INSPEKTIME, RI-INSPEKTIME DHE MONITORIME VITI 2020

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MONITORIME
BERAT	978	3	19 101
DIBER	594	4	14 996
DURRES	977	45	60 220
ELBASAN	920	8	25 838
FIER	1 133	13	29 408
GJIROKASTER	431	13	23 461
KORCE	710	0	28 607
KUKES	613	2	18 226
LEZHE	515	30	17 063
SHKODER	616	82	21 392
TIRANE	1 457	18	64 163
VLORE	976	26	52 225
QENDRORI	69	1	18 974
GJITHSEJ	9 989	245	393 674

1.5 Masa Administrative

Trupa inspektuese e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor ka vendosur gjatë vitit 2020:

- 707 Masa Administrative në lekë në vlerën 128.624.000 Lekë.
- 395 Vendime të Ndërmjetme për Pezullim Aktivitetit
- 300 Paralajmërimë
- 128 624 000 Lekë është vlera e Masave Administrative.
- 519 Masa Administrative të falura me Akte Normative
- 84 098 000 Lekë është vlera e Masave Administrative të falura.

MASA ADMINISTRATIVE VITI 2020

QARKU	MASA ADMINISTRATIVE/LEKË	VENDIME	PARALAJMERIME
BERAT	24	115	3
DIBER	13	81	20
DURRES	186	30	0
ELBASAN	23	37	4
FIER	20	14	31
GJIROKASTER	30	39	52
KORCE	40	11	0
KUKES	28	0	0
LEZHE	21	2	29
SHKODER	63	5	0
TIRANE	201	34	105
VLORE	45	26	52
QENDRORI	13	1	4
GJITHSEJ	707	395	300

1.6 Inspektimet e kryera gjatë vitit 2020 sipas fushave të inspektimit:

INSPEKTIME SIPAS FUSHAVE	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MONITORIME
INSPEKTIME “ANTI COVID-19”	3 316	1	392 621
INSPEKTIME SHËNDETËSORE	1 172	61	0
INSPEKTIME SANITARE/TË TJERA	5 501	183	1 053

INSPEKTIVE “ANTI COVID-19”.

Gjatë vitit 2020 trupa inspektuese e ISHSH ka kryer kontrole të vazhdueshme për zbatimin e protokolleve për mbrojtjen dhe parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ISHSH, është institucioni kryesor i ngarkuar me zbatimin e Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” e të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19.

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 395 938 inspektive, ri-inspektive dhe monitorime anti COVID-19, me qëllim:

- Zbatimin e Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar.
- Zbatimin e të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19.
- Zbatimin e Protokolleve të miratuar për mbrojtjen dhe parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

INSPEKTIVE SHËNDETËSORE

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 1 233 inspektive dhe ri-inspektive shëndetësore, me qëllim:

- Mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes procesit inspektues të respektimit të legjislacionit në fuqi në institucionet e kujdesit shëndetësor.
- Rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe standarteve ndaj popullatës në institucionet e kujdesit shëndetësor.

INSPEKTIVE SANITARE DHE INSPEKTIVE PËR LIGJE TË TJERA

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 6 737 inspektive, ri-inspektive dhe monitorime sanitare dhe inspektive të tjera.

Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, janë kryer inspektive të vazhdueshme të kushteve higjieno sanitare dhe shëndetësore në qendrat e akomodimit të qytetarëve të dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Këto inspektive kanë qënë të përditshme në të gjitha 39 qendrat e akomodimit të qytetarëve të dëmtuar.

Objekti i inspektiveve ka qënë:

- Kontrolli dhe zbatimi i të gjitha ligjeve e akteve nënligjore higjieno-sanitare në sektorët shtetërorë, privatë, veprimtaritë e ndryshme të ushtruara nga persona fizikë e juridike, vendas e të huaj të cilët veprojnë në fushat e mëposhtëme të zbatimit.
- Kontrolli dhe përgjigja në kohë në situata emergjente për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, duke bërë koordinimin me strukturat e inspektoratit në qarqe.
- Identifikimi i situatave të mundshme të rrezikshme që dëmtojnë shëndetin e punonjësve që janë në kontakt me to, përtej normave të lejuara.

- Mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe garantimin e cilësisë së produkteve kozmetike të bëra të disponueshme në treg, duke përcaktuar kërkesat që duhet të përmbushë çdo produkt kozmetik.
- Nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji, si dhe të rregullojë tregtimin e zëvendësuesve të qumështit të gjirit për të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijëve.
- Parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, nëpërmjet jodizimit të përgjithshëm të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.
- Mbrojtjen e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre.
- Parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, nëpërmjet përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit

INSPEKTIVE “ANTI COVID-19”

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ISHSH, është institucioni kryesor i ngarkuar për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, masa të cilat rrjedhin prej Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjatë vitit 2020 trupa inspektuese e ISHSH ka kryer kontrole të pandërprera për zbatimin e protokolleve të masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Inspektimet dhe monitorimet janë bazuar në Ligje, Akte Normative dhe Urdhëra të nxjerra apo miratuara me qëllim përballimin e situatës dhe ndalimin e përhapjes së infeksionit.

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 395 938 inspektive, ri-inspektive dhe monitorime anti COVID-19, me qëllim:

- Zbatimin e Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar.
- Zbatimin e të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19.
- Zbatimin e Protokolleve të miratuar për mbrojtjen dhe parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

INSPEKTIVE COVID-19	INSPEKTIVE	RI-INSPEKTIVE	MONITORIME	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA	VENDIME & PARALAJMERIME
Institucionet e Shërbimit Shëndetësor	223		3871	47	1	46
Pika të shitjeve të produkteve ushqimore	710		49096	92	88	4
Furra buke/ pasticëri	251		13859	58	56	2
Bar-kafe/restorante/ piceri/ fast food	238		107622	152	140	12
Farmaci	193		10975	24	22	2
Klinika/ laborator dentar	31		5977	4	4	
Subjekte argetimi, qendra interneti, loja për fëmijë, etj.	2		539	0		
Biznese; fason/ call center/ fabrika	416	1	2725	152	44	108
Miniera	15		24	6	1	5
Subjekte armore	405		5985	45	1	44
Berber/parukeri	13		9425	0		
Hotele	8		1857	3	2	1
Sportelet Pagesash	165		7615	45	23	22
Shitje me pakicë e produkteve jo ushqimore	96		42236	18	17	1
Subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm	18		161	8	2	3
Shërbime të ndryshme riparimi	33		1683	4	4	
IEVP	38		19	5		5
MEDIA TV	2		4	3	2	1
Institucione Publike	334		1195	124	4	120
Taxi/Mjete Transporti	9		234	8	8	
Individ	110		127253	110	110	
Pishinat	6		148	5	3	2
Sipërmarrje të Aktiviteteve Turistike			118	0		
				0		
GJITHSEJ	3316	1	392621	913	532	378

Inspektive dhe monitorime në Pikat e Kalimit të Kufirit.

Njësia e Inspektimit Shëndetësor në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas monitoron në mënyrë të vazhdueshme të gjithë pasagjerët që hyjnë në Republikën e Shqipërisë dhe plotësimin e Formularit të Vlerësimit dhe Investigimit për udhëtarët që hyjnë në Shqipëri.

Në pikat e kalimit kufitar detar inspektorët e ISHSH në bashkëpunim me NJVKSH kryen kontrolle në portet e Durrësit, Vlorës, Sarandës, për matjen e temperaturës të pasagjerëve dhe të gjithë drejtuesve të mjeteve të transportit detar në periudhën shkurt mars 2020.

PIKA E KALIMIT TË KUFIRIT	AEROPORTI RINAS	PORTI DURRE	PORTI VLORE	PORTI SARANDE
Numri i kontrolleve	433 252	12 051	1 713	773

Problematika e hasur:

- Zhvillim i aktivitetit në subjekte, në shkelje të Urdhërave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për mbylljen e tyre.
- Moszbatim i Akteve Normative për mbylljen e të gjitha aktiviteteve me qëllim mbrojtjen e popullatës nga përhapja e Virusit COVID-19.
- Ushtrim i aktivitetit nga ana e personelit, pa marë masat mbrojtëse (pa vendosur maskat dhe dorezat).
- Mosrrespektimi i distancave ndërmjet punonjësve në biznese.
- Mungesa e dezinfektantëve për punonjësit dhe klientët.
- Mungesë e personit përgjegjës për shëndetin në punë.
- Mungesë e procesverbalit të matjes së temperaturës, mbajtur nga personi përgjegjës për shëndetin në punë.
- Mungesa e vërtetimit nga e-albania për ushtrimin e aktivitetit në subjekte.
- Mungesa e afishimit të posterave dhe protokolleve të miratuara në hyrje të subjektit.
- Mungesa e tuneleve të dezinfektimit në subjektet me mbi 50 punonjës.
- Mungesa e termometrit infrared.
- Mungesa e shenjave të distancimit social prej 2 metrash.
- Mungesa e xhamit mbrojtës në kasën e pagesës.
- Mungesa e dezinfektantëve në hyrje të subjekteve tregtare.
- Dhënia e shërbimit në ambiente të mbyllura në kundërshtim me Urdhërin nr. 320 të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Mospërdorimi i maskave në ambiente të mbyllura dhe në ambientet e jashtëme nga individët.
- Mosrrespektim i karantinës nga individë.
- Zhvillim i tubimeve, në shkelje të Urdhërave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Organizim i ceremonive martesore në kundërshtim të Urdhërit nr. 351 të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Hapja e pishinave, në shkelje të Urdhërave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Problematika në shkollë/kopshte/çerdhe

- Mungesë uji i rrjedhshëm në shkollë
- Mungesë termometri dixhital
- Mungon vasketa për disinfektim në hyrje të shkollës.
- Mungojnë rregullat e afishuara në cdo kat të ambientit dhe dezinfektimi i kopshtit është i pa dokumentuar.

- Nuk ka dokument dezinfektimi.
- Ka mungesa në detergjentëve për pastrim dhe dezinfektantëve.
- Mungon dhoma e veçantë për nxënësit me temperaturë apo me simptoma.
- Mungesa e personelit sanitar dhe rojeve në disa shkolla
- Mungesë e depozitave të ujit.
- Mungesë e personelit shëndetësor ose është me kohë të pjesshme.
- Grumbullime të familjarëve pa maska mbrojtëse para dyerve të shkollave/kopshteve.

INSPEKTIVE SHËNDETËSORE

- Inspektive Spitalore.
- Inspektive Ambulatore.
- Inspektive për zbatimin e Ligjit nr. 9928, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik” të ndryshuar.
- Inspektive për zbatimin e Ligjit nr. 10469 “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”
- Inspektive për Plotësimin e Standardeve të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.

Inspektive Spitalore.

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH, kryen 73 inspektive dhe ri-inspektive me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes procesit inspektues të respektimit të legjislacioneve në fuqi për kujdesin spitalor.

- 71 inspektive
- 2 ri-inspektive

QARKU	INSPEKTIVE	RI-INSPEKTIVE	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA	VENDIME & PARALAJMERIME
BERAT	6				
DIBER	6		2		2
DURRES	6				
ELBASAN	9				
FIER	8		1		1
GJIROKASTER	3		2		2
KORCE	8				
KUKES	7				
LEZHE	4	1	2	1	1
SHKODER	4				
VLORE	4	1	2	1	1
QENDRORI	6				
GJITHSEJ	71	2	9	2	7

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 2 Masa Administrative në lekë (1 rrezatim)
- 7 Paralajmërimë.

Problematika e hasur:

- Mungesa e Akt- Miratimit higjieno sanitar.
- Moskryerja e shërbimit DDD në ambjentet e jashtëme e të brendshme.
- Personeli mjekësor i pa pajisur me dokumentacionin shëndetësor të detyrueshëm.
- Mungesë e licencës për pajisjet me burim të rrezatimit jonizues.
- Ambientet e spitalit nuk janë të mjaftueshme për funksionimin me kapacitet të plotë.(Dibër)
- Disa nga autoambulancat janë të amortizuara dhe kanë mangësi në paisjet bazë të ndihmës së parë.

- Kushte higjiene sanitare jo të mira në ambjentet e spitaleve (dysHEMEJA, muret, tavanet e dhomave, korridoreve, pavioneve, tualeteve) dhe ambjente të tjera, janë të amortizuara dhe me lagështirë.

Inspektive Ambulatore

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 1073 inspektive dhe ri-inspektive ambulatorie me qëllim garantimin dhe respektimin e kërkesave ligjore në fushën e kujdesit ambulator për mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes procesit inspektues të respektimit të legjislacioneve në fuqi për kujdesit ambulator.

- 1016 inspektive
- 57 ri-inspektive

QARKU	INSPEKTIVE	RI-INSPEKTIVE	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA	VENDIME & PARALAJMERIME
BERAT	36	2	1		1
DIBER	23	2	4		4
DURRES	121	28			
ELBASAN	80		1		1
FIER	119	3	12	1	11
GJIROKASTER	42		17		17
KORCE	67				
KUKES	31				
LEZHE	86	3	4	1	3
SHKODER	83	8	1	1	
TIRANE	214	2	20	2	18
VLORE	113	9	9		9
QENDRORI	1		2	1	1
GJITHSEJ	1016	57	71	6	65

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 6 Masa Administrative në lekë (4 për rrezatim)
- 2 Vendime të Ndërmjetëm Për Mbyllje Provizore. (2 për rrezatim)
- 63 Paralajmërimë.

Problematika e hasur:

- Mungesë e dokumentacionit higjiene sanitare të subjektit (Akt-Miratim higjiene-sanitar, certifikata DDD, raport analiza e ujit të pijshëm)
- Mungesë e dokumentacionit shëndetësor të personelit mjekësor.
- Mungesë e kontratës për evadimin e mbetjeve spitalore
- Mungesë e licencës të ushtrimit të aktivitetit (QKL).
- Mungesa e Lejes së Ushtrimit të Profesionit
- Dëmtim i ambienteve të subjekteve nga tërmeti i 26 nëntorit 2019
- Mosrinovim i licencës për pajisjet me burim rrezatues.
- Mungesa e ambienteve të vecanta për marrjen e mostrës së gjakut në laborator.
- Nuk kryhet ndarja në burim e mbetjeve spitalore
- Mungojnë kontenierët e mbetjeve spitalore në çdo pavion sipas llojit të mbetjeve
- Mungon hapësira për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore

Inspektime për zbatimin e Ligjit nr. 9928, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik” të ndryshuar

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 57 inspektime dhe ri-inspektime në kabinetet dentare publike dhe jo publike dhe laboratorët dentarë publikë dhe jo publikë.

- 56 inspektime
- 1 ri-inspektime

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA	VENDIME & PARALAJMERIME
BERAT	1				
DURRES	2				
ELBASAN	6				
KUKES	16				
TIRANE	15	1	5	2	3
VLORE	2				
QENDRORI	14				
GJITHSEJ	56	1	5	2	3

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 2 Masa Administrative në lekë.
- 3 Paralajmërime.

Problematika:

- Mungesa e lejeve të ushtrimit të profesionit (UMSH-USSH)
- Mungesa e kontratave për evadimin e mbetjeve spitalore
- Mungesa në dokumentacionin higjieno sanitarë të subjektit: Akt-Miratim higjieno sanitarë, certifikata DDD, raport analiza e ujit të pijshëm.
- Mungesë e dokumentacionit shëndetësor të punonjësve: Libreza shëndetësore, KML.

Inspektime për zbatimin e Ligjit nr. 10469 “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen inspektime në subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues.

Inspektimet janë kryer si pjesë e inspektimeve shëndetësore në Qendrat Spitalore në Tiranë, spitalet rajonale, spitale bashkiake, klinika mjeksore, klinika dhe kabinete dentare etj.

Gjithashtu janë kryer edhe:

- 2 inspektime bazuar në informacionin e ardhur nga Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet.

Problematika e hasur gjatë inspektimeve.

- Mungesë license e subjekteve që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues.
- Vonesa në procesin e ri-liçensimit të subjekteve që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues.

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 4 Masa Administrative në lekë (2 rrezatim)
- 2 Vendime të Ndërmjetëm Për Mbyllje Provizore

Inspektime për plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor gjatë vitit 2020 ka kryer 28 inspektime për plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore.

Inspektimet janë kryer bazuar në VKM nr. 865, datë 24.12.2020, “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”, si dhe në Urdhërin nr. 630, datë 29.12.2017 “Për plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore” të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Objekt i inspektimit ka qenë:

- Inspektimi i zbatueshmërisë ligjore në përputhje me specialitetet e përcaktuara në licencat përkatëse
 - Inspektimi i dokumentacionit
 - Inspektimi i plotësimit të kushteve higjieno sanitare të ambjenteve ku kryhen vizita dhe ekzaminime
 - Inspektimi i pajisjeve dhe aparaturave mjeksore
 - Inspektimi i menaxhimit dhe administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore
-
- 27 inspektime
 - 1 ri-inspektime

Problematika:

- Mungon stafi mjekësor i specializuar
- Mungesë e kushteve dhe e dokumentacionit higjieno sanitar
- Mungojnë detajet ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara (PAK), të cilat si rrjedhojë shkaktojnë pamundësi të hyrjes së tyre në objekt.

Nga ky inspektim rezultoi se:

- 14 Qendra Mjekësore jo publike përmbushin standartet bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit në përputhje me specialitetet e përcaktuara në Licencat përkatëse.
- 7 Qendra Mjekësore jo publike dhe 2 Qendra Shëndetësore publike nuk përmbushin standartet bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për asnjë nga specialitetet e përcaktuara në Licencat përkatëse.
- 5 Qendra Mjekësore janë gjetur të mbyllura

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, qendror, për gjithë inspektimet e kryera në Qendrat Mjekësore jo publike me qëllim plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit në këto Institucione Shëndetësore ka hartuar dhe raportin përkatës i cili është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

INSPEKTIVE SANITARE DHE INSPEKTIVE PËR LIGJE TË TJERA

- Inspektive në subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Inspektive në institucione parashkollore, shkollore, institucione të arsimit të lartë dhe subjekte të akomodimit dhe shërbimit të tyre.
- Inspektim në shtëpitë e të moshuarve publike dhe jopublike, institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit për fëmijë.
- Inspektimi i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, IEVP, paraburgimit dhe ambienteve të ndalimit në Drejtoritë e Policisë dhe Komisariate.
- Inspektimi i ndërmarrjeve për kujdesin shëndetësor në punë.
- Inspektive për zbatimin e Ligjit nr. 26/2017 “Për produktet kozmetike”.
- Inspektive për zbatimin e Ligjit nr. 8528 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji” të ndryshuar.
- Inspektive për zbatimin e Ligjit nr. 9942 datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” të ndryshuar.
- Inspektive për zbatimin e Ligjit nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” të ndryshuar.
- Inspektimet e kryera për zbatimin e Ligjit nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar” të ndryshuar.
- Inspektive Sanitare për pajisjen me Akt-Miratim higjieno sanitar, inspektive sanitare në bazë të ankesave apo denoncimeve.

Inspektive në subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm

Gjatë vitit 2020, janë kryer 175 inspektive dhe ri-inspektive në subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm.

- 163 inspektive
- 12 ri-inspektive

Problematika e hasur gjatë inspektiveve dhe ri-inspektiveve të vitit 2020:

- Mungesa e aparatit për dozimin e lëndës dezinfektante , klorinim manual
- Depo të parrethuara dhe të amortizuara me prani të lagështisë.
- Mungesë e rrethimit të zonave të mbrojtjes sanitare.
- Bimësi e rritur dhe papastërti në zonat e mbrojtjes
- Mungesë e analizës periodike për kontrollin e cilësisë së ujit/ lëndës dezinfektante të ujit.
- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm shëndetësor të punonjësve.
- Mungesë e Akt-Miratimit higjieno sanitar të objekteve të UK.
- Moskryerja e shërbimit të dezinfektimit (DDD)
- Nuk ka regjistra për dokumentimin e dezinfektimit të depove.
- Mungesë e rojes 24 orë në depo
- Mungesë e ambienteve të veçantë për mbajtjen e dezinfektantëve të objekteve dhe të ujit si dhe të dokumentacioneve përkatëse.

Gjatë inspektiveve ose në bazë të denoncimeve për ndotje të ujit të pijshëm janë vendosur:

- 1 Masa Administrative në lekë.
- 2 Vendime të ndërmjetme.
- 12 Paralajmërime.

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA	VENDIME & PARALAJMERIME
BERAT	16				
DIBER	3	1			
DURRES	1				
ELBASAN	21	1	2	1	1
FIER	62				
GJIROKASTER	7		6		6
KUKES	9	1			
LEZHE	3				
SHKODER	5				
TIRANE	13	2			
VLORE	23	7	7		7
GJITHSEJ	163	12	15	1	14

Inspektime në institucione parashkollore, shkollore, institucione të arsimit të lartë dhe subjekte të akomodimit dhe shërbimit të tyre.

Gjatë vitit 2020 u kryen 542 inspektime dhe ri-inspektime të subjekteve publike dhe jopublike arsimore parashkollore, shkollore, në institucionet e arsimit të lartë, si dhe në konviktet dhe mencat e institucioneve të arsimit të mesëm dhe të lartë me qëllim inspektimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në institucionet arsimore për të siguruar optimumin shëndetësor të kushteve të mësimi, jetesës e shlodhjes si dhe kontrollin në pikat kritike në të gjithë zinxhirin për prodhimin dhe konsumin e produkteve ushqimore.

- 540 inspektime
- 2 ri-inspektime

Problematika e hasur:

- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm higjieno sanitar për subjektin dhe për personelin.
- Moskryerja e shërbimit të dezinfektimit (DDD)
- Amortizim i ndërtesave të shkollave.
- Prania e lagështirës në ambientet e institucioneve.
- Amortizimi i bazës materiale të shkollave (banka, karrige etj).
- Amortizim i rrjetit elektrik dhe hidraulik.
- Mungesë e ngrohjes në ambiente
- Mungesë e rrethimit të subjektit
- Mungesa e palestrës dhe ambienteve sportive në shkolla.
- Mungesa e laboratorëve mësimorë.
- Gjendje e rënduar e anekseve higjieno-sanitare, dhe e pajisjeve të tyre.
- Aneks hidro sanitar të jashtë ambienteve të shkollës (shkollat e zonave rurale)
- Amortizim i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza
- Mosfurnizim me ujë të rrjedhshëm, mungesa e ujit të ngrohtë.

- Numri i nyjeve hidrosanitare është shumë herë më i vogël se normat e lejuara.
- Shkolla të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit
- Ka mungesa në pajisjen e bllokut të gatimit në kopshte.
- Mungesa e ambienteve të domosdoshëm në Cerdhe
- Tualetë të papërshtatshme për grup moshën në kopshte/cerdhe.

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 3 Vendime të Ndërmjetëm Për Mbyllje Provizore.
- 87 Paralajmërime

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MASA ADMINISTRATIVE	VENDIME & PARALAJMERIME
BERAT	48		2	2
DIBER	37		14	14
DURRES	13			
ELBASAN	35			
FIER	50		13	13
GJIROKASTER	50		24	24
KORCE	47		1	1
KUKES	7	1		
LEZHE	16			
SHKODER	34		2	2
TIRANE	88	1	15	15
VLORE	115		19	19
GJITHSEJ	540	2	90	90

Inspektime në shtëpitë e të moshuarve, publike dhe jopublike, institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit për fëmijë.

Gjatë vitit 2020 trupat inspektuese të ISHSH kryen 87 inspektime dhe ri-inspektime në shtëpitë e të moshuarve publike dhe jopublike, institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit për fëmijë me qëllim monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore për respektimin e kushteve higjieno-sanitare në këto institucione të kujdesit social.

Problematika në shtëpitë e të moshuarve publike dhe jopublike, institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit për fëmijë

Problematika në shtëpitë e të moshuarve publike dhe jopublike, institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit për fëmijë

- Mungesë e Akt-Miratimit higjieno sanitar
- Mungesë e kryerjes së shërbimit të dezinfektimit (DDD)
- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm shëndetësor të personelit (libreza shëndetësore, KML).
- Mungesa e raportit mjeko ligjor të personelit
- Amortizim dhe prani të lagështisë në ambientet e subjekteve (lavanderisë, kuzhinës dhe në dhomat e ndenjes).
- Mungesë e ujit të ngrohtë
- Mungesa e mjekut për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

- Mungesë e personelit sanitar në institucion

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 1 Masa Administrative në lekë.
- 12 Paralajmërimë

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA	VENDIME & PARALAJMERIME
BERAT	4				
DIBER	2				
DURRES	9	6			
ELBASAN	6				
FIER	1				
GJIROKASTER	2		2		2
KORCE	10				
LEZHE	1	1	2	1	1
SHKODER	7	5			
TIRANE	23	4	7		7
VLORE	5	1	2		2
GJITHSEJ	70	17	13	1	12

• **Inspektimi i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, IEVP, paraburgimit dhe ambienteve të ndalimit në Drejtoritë e Policisë dhe Komisarjate.**

Gjatë vitit 2020 trupat inspektuese të ISHSH kryen 11 inspekte dhe ri-inspekte në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, IEVP, si dhe ambientet e ndalimit në Drejtoritë e Policisë në Qarqe dhe Komisarjate me qëllim monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore për respektimin e kushteve higjieno-sanitare në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të paraburgimit.

- Kushtet jashtë normave higjieno sanitare.
- Ka mungesë të bazës materiale.
- Kushte jo të përshtatëshme të nyjeve hidro/sanitare.
- Lagështi në ambientet ku qëndrojnë të burgosurit.
- Kushte jashtë normave higjieno sanitare të kuzhinës
- Nuk është kryer shërbimi DDD
- Mungesë e kontratës për evadimin e mbetjeve spitalore

Gjatë vitit 2020 janë kryer 9 inspekte dhe 2 ri-inspekte dhe janë vendosur:

- 1 Masa Administrative në lekë për mosplotësim të detyrave të lëna.

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA
FIER		1	1	1
KORCE	1			
KUKES	2			
SHKODER	1	1		
VLORE	5			
GJITHSEJ	9	2	1	1

Inspektimi i ndërmarrjeve për kujdesin shëndetësor në punë.

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 381 inspektime dhe ri-inspektime me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, formimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre.

- 359 inspektime
- 22 ri-inspektime

Objekti i inspektimit

Në të gjitha ndërmarrjet ku punëdhënësit klasifikohen sipas numrit të punëmarrësve në grupet A, B C, D.

Problematika:

- Mungesë e Akt-Miratimit higjieno sanitar.
- Mungesë e Certifikatës DDD.
- Punonjës të pa pajisur me dokumentacionin bazë mjekësor.
- Mungesë e pajisjeve të nevojshme në dhomës e mjekut të punës
- Mos plotësimi i saktë i kartelave mjekësore
- Mungesë e gardorobës dhe mencës.
- Problematikë në kushtet dhe standartet higjieno sanitare në ambientet e punës.

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 1 Masë Administrative në lekë.
- 17 Paralajmërimë

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA	VENDIME & PARALAJMERIME
BERAT	14				
DIBER	3				
DURRES	54	3			
ELBASAN	16				
FIER	35	3	5		5
GJIROKASTER	24	1	1		1
KORCE	25				
LEZHE	9				
SHKODER	35	7			
TIRANE	82	2	1	1	
VLORE	62	6	11		11
GJITHSEJ	359	22	18	1	17

Inspektime për zbatimin e Ligjit nr. 26/2017 “Për produktet kozmetike”.

Gjatë vitit 2020 u kryen 9 inspektime në subjekte importuese dhe tregtuese të produkteve kozmetike me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe garantimin e cilësisë së produkteve

kozmetike të bëra të disponueshme në treg, duke përcaktuar kërkesat që duhet të përmbushë çdo produkt kozmetik.

Objekti i inspektimit:

- Të gjitha subjektet tregtuese.
- Të gjitha subjektet prodhuese, (çdo person fizik ose juridik i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, i cili prodhon një produkt kozmetik ose ka një produkt të tillë të disenjuar ose të prodhuar dhe tregton këtë produkt kozmetik sipas emrit ose markës së tij të regjistruar).
- Të gjitha subjektet përdoruese.
- Të gjitha subjektet mjekësore, (janë subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin për ofrimin e shërbimeve mjekësore, pjesë e të cilave është dhe përdorimi i produkteve kozmetike).
- Të gjitha subjektet mjekësore të specializuara.

Problematika:

- Mos raportimi pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bazuar në Ligj nr. 26/2017 “Për Produktet Kozmetike”.

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 1 Masë Administrative në lekë.
- 5 Paralajmërimi.

Inspektime për zbatimin e Ligjit nr. 8528 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjë” të ndryshuar.

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 20 inspektime dhe ri-inspektime për monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 8528 i datës 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjë” të ndryshuar.

Problematika

- Mungesa e etiketimit të produkteve në gjuhën shqipe.
- Mungesë e përshkrimit të përcaktuar në ligj.

Inspektime për zbatimin e Ligjit nr. 9942 datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” të ndryshuar,

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 649 inspektime për monitorimin e zbatimit të ligjit nr. nr. 9942 datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” të ndryshuar.

Problematika

- Mungesë e raport-analizës së kripës së joduar.
- Mungesë e etiketimit në gjuhën shqipe të ambalazhit të kripës.
- Mungesë e datës së prodhimit dhe skadencës në ambalazhin e kripës
- Mungesë e nivelit të jodit dhe llojit të fortifikimit në ambalazhin e kripës.

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 2 Masa Administrative në lekë.
- 1 Paralajmërim.

Inspektime për zbatimin e Ligjit nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” të ndryshuar.

Në Shqipëri, që nga viti 2006 është në fuqi ligji nr. 9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” i ndryshuar, i njohur ndryshe edhe si “*ligji antiduhan*”.

Megjithë vështirësitë e hasura, rezultatet e punës së ISHSH janë lehtësisht të dukshme për të gjithë dhe janë vlerësuar si të suksesshme nga të gjitha palët e interesuara.

Në Progres Raportin e Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2020 vlerësimi në lidhje me zbatimin e ligjit në fjalë është: “*Në lidhje me kontrollin e duhanit, Ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, i cili është përgatitur të jetë në përputhje me Acquis, është duke u zbatuar plotësisht*”.

- Vlerësime të tilla pozitive janë në vazhdimësi nga viti 2015 kur ka filluar punë ISHSH ndërkohë që në vitin 2014 kur ISHSH nuk kishte filluar nga funksionimi vlerësimi është: “*...Përprjekje të mëtijshme janë të nevojshme për zbatimin e duhur të tij. Pirja e duhanit mbetet e përhapur në vende publike dhe produktet e duhanit vazhdojnë të shiten në rrugë, veçanërisht nga të miturit*”

ISHSH ka kryer 3712 inspektime dhe monitorime për zbatimin e ligjit nr. 9636 dhe ka vendosur 118 masa administrative në lekë gjatë vitit 2020.

- 2659 Inspektime
- 1053 Monitorime

QARKU	INSPEKTIME	MONITORIME	MASA ADMINISTRATIVE
BERAT	194	0	6
DIBER	229	54	1
DURRES	233	0	33
ELBASAN	162	27	4
FIER	155	52	0
GJIROKASTER	94	411	3
KORCE	267	198	5
KUKES	307	254	2
LEZHE	224	0	4
SHKODER	112	0	8
TIRANE	452	42	46
VLORE	230	15	6
GJITHSEJ	2659	1053	118

Pavarësisht situatës së krijuar jo nga pandemia COVID-19, ISHSH ka vijuar të ketë në fokus të punës zbatimin e ligjit nr. 9636. Mbyllja dhe karantinimi i vendit, operimi i bareve dhe restoranteve me orare të kufizuara reflektohen në numrin e relativisht të ulët të inspektimeve dhe monitorimeve të kryera gjatë vitit 2020.

Inspektime për zbatimin e Ligjit nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar” të ndryshuar.

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19, mbyllja dhe karantinimi i vendit, operimi i bareve dhe restoranteve me orare të kufizuara reflektohen në numrin e relativisht të ulët të inspektimeve dhe monitorimeve të kryera gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, trupat inspektuese të ISHSH kryen 260 inspektime për monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 9518. Problematika e hasur gjatë inspektimeve ishte: Mungesë shënje ndaluese konsumi alkooli për personat nën 18 vjeç

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 17 Masa Administrative në lekë.

QARKU	INSPEKTIME	MASA ADMINISTRATIVE
BERAT	32	0
DIBER	13	0
DURRES	71	0
ELBASAN	4	4
FIER	22	1
GJIROKASTER	60	0
KUKES	9	9
SHKODER	28	1
TIRANE	2	2
VLORE	19	0
GJITHSEJ	260	17

Inspektime sanitare për pajisjen me Akt-Miratim Higjieno Sanitar, inspektime sanitare në bazë të ankesave apo denoncimeve

Gjatë vitit 2020 trupat inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor kanë kryer 901 inspektime dhe ri-inspektime të tjera, (773 inspektime dhe 128 ri-inspektime) bazuar në kërkesa për pajisje me Akt-Miratim higjieno sanitar, si dhe inspektime të kryera nga denoncimet dhe ankesat e ndryshme ardhur pranë ISHSH.

Gjatë vitit 2020 janë vendosur:

- 17 Masa Administrative në lekë.
- 11 Vendime të Ndërmjetëm Për Mbyllje Provizore.

- 92 Paralajmërimë.

QARKU	INSPEKTIME	RI-INSPEKTIME	MASA ADMINISTRATIVE	GJOBA	VENDIME & PARALAJMERIME
BERAT	12				
DIBER	9	1	1		1
DURRES	52	8			
ELBASAN	62	7	1	1	
FIER	33	6	2	1	1
GJIROKASTER	7	10	1		1
KORCE	41				
KUKES	1				
LEZHE	41	25	24		24
SHKODER	61	61			
TIRANE	331	6	85	12	73
VLORE	110	2	5	2	3
QENDRORI	1		1	1	
GJITHSEJ	760	126	120	17	103

- Gjatë vitit 2020 janë pajisur me Akt Miratim higjiëno sanitar 1117 subjekte.

QARKU	AKT MIRATIME HIGJIENO SANITARE
BERAT	16
DIBER	8
DURRES	94
ELBASAN	94
FIER	41
GJIROKASTER	11
KORCE	56
KUKES	4
LEZHE	40
SHKODER	88
TIRANE	524
VLORE	141
GJITHSEJ	1117

2. SEKTORI JURIDIK

2.1. Sektori Juridik dhe i Hartimit të Proçedurave të Inspektimit (ISHSH qendror)

2.2. Sektori Juridik (ISHSH rajonal)

2.1. Sektori Juridik dhe i Hartimit të Proçedurave të Inspektimit (ISHSH qendror)

Sektori juridik synon zbatimin dhe sqarimin juridik të kuadrit ligjor që lidhet me fushën objekt inspektimi të ISHSH për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit të ISHSH në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.

Sektori Juridik dhe i Hartimit të Proçedurave të Inspektimit (ISHSH qendror) përbëhet nga:

1 (një) Përgjegjës sektori

2 (dy) Specialistë

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit Juridik dhe të Hartimit të Proçedurave të Inspektimit (ISHSH qendror)

- Harton projekt rregulloret dhe urdhërat që nxjerr Kryeinspektori në bashkepunim me sektorin përkatës.
- Jep mbështetje ligjore për sektorët e tjerë të ISHSH qendror si dhe ISHSH në nivel rajonal;
- Përfaqeson institucionin në proçeset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit për çështje të ndryshme ku ISHSH thirret si palë apo inicion vetë një proces gjyqësor.
- Në zbatim të ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurim publik” të ndryshuar dhe të VKM të nxjerra në zbatim të këtij ligji, ndjek dhe zbaton të gjitha proçedurat e prokurimeve publike për plotësimin e nevojave me mallra, shërbime e punë të ISHSH në nivel qendror dhe rajonal.
- Mbështet proçesin e përgatitjes dhe menaxhimit të buxhetit të ISHSH si dhe administratimin e prokurimeve publike të nevojave të ISHSH në nivel qendror dhe rajonal.
- Me autorizim të Kryeinspektorit mund të kërkojë nga organet shtetërore ose personat juridikë informacione, njoftime dhe dokumenta.
- Shërben si pikë kontakti për të gjithë Sektorët e ISHSH në nivel rajonal.
- Përveç detyrave dhe përgjegjësi të mësipërme, kryen dhe detyra të tjera, të ngarkuara nga Kryeinspektori.
- Përgjegjësi i Sektorit Juridik dhe i Hartimit të Proçedurave të Inspektimit raporton me shkrim çdo muaj për ecurinë e punëve brenda sektorit pranë Kryeinspektorit të ISHSH.

2.2. Sektori Juridik (ISHSH rajonal)

Sektori Juridik (ISHSH rajonal) përbëhet nga:

Përgjegjës sektori

Specialist jurist

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit Juridik (ISHSH rajonal).

- Ndjek zbatimin e proçedurave të ankimit gjyqësor në të gjitha shkallët e ankimit, ku palë është Dega Rajonale e ISHSH;
- Koordinon punën me Sektorin juridik pranë ISHSH-së për përgatitjen dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e shëndetit publik dhe atë të inspektimit;

- Jep ndihmesën e nevojshme juridike në zbërthimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, në bashkëpunim me sektorët e tjerë;
- Përgjigjet dhe sqaron nga ana ligjore kërkesat e Institucioneve të ndryshme shëndetësore, si dhe të qytetarëve, duke iu dhënë zgjidhje rasteve e problemeve që dalin gjatë praktikës, të cilat lidhen me zbatimin e legjislacionit shëndetësor;
- Ndjek dhe përfaqëson Degen Rajonale në çeshtje të ndryshme gjyqësore e mosmarrëveshje administrative dhe informon Kryeinspektorin për ecurinë e tyre;
- Përgatit dosjet gjyqësore me të gjitha aktet administrative;
- Përgatit dhe ndjek dosjet për urdhrat e ekzekutimit të masave administrative;
- Ndjek zbatimin e afateve procedurale;
- Ndjek zbatimin e procedurave të ankimeve administrative, pranë Komisionit të ankimit në ISHSH-së, si dhe dokumentacionit përkatës;

Gjatë vitit 2020 janë përgatitur një sërë aktesh nënligjore për zbatueshmërinë e ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e ISHSH.

Gjatë vitit 2020 pranë ISHSH qendror janë zhvilluar 7 (shtatë) Komisione të Ankimit Administrativ të Trupës Kolegjiale të ISHSH.

- 358 - Masa Administrative të shqyrtuara.
 - 351 - Masa Administrative të lëna në fuqi.
 - 4 - Masa Administrative të anulhuara.
 - 1 % - Përqindja e Masave Administrative të Anulhuara.
-
- 707 Masa Administrative janë vendosur gjatë vitit 2020 nga ISHSH.
 - 519 Masa Administrative janë falur me Akte Normative gjatë vitit 2020 me Vendim të Këshillit të Ministrave
 - 322 Masa Administrative me Vendim Urdhër Ekzekutimi janë dërguar nga ISHSH.
 - 239 Proçese Gjyqësore të Zhvilluar gjatë vitit 2020
 - 95 Proçese Gjyqësore të fituar
 - 68 Proçese Gjyqësore të humbur
 - 77 Proçese Gjyqësore në procedurë

3. SEKTORI I FINANCËS DHE I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

3.1. Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse (ISHSH qendror)

3.2. Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse (ISHSH rajonal)

3.1. Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse (ISHSH qendror)

Ky sektor ka për qëllim të menaxhojë sistemin buxhetor të ISHSH, ashtu si dhe është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore të ISHSH dhe krijimin dhe ngritjen e një administrate sa më të qëndrueshme, profesionale dhe efçente nëpërmjet:

- Ndekjes së politikës së zhvillimit të institucionit në zbatim të legjislacionit përkatës për të gjitha çështjet e punësimit dhe menaxhimit të personelit të ISHSH-së.
- Krijimit të kushteve sa më të përshtatshme për administratën, të cilat inkurajojnë zhvillimin e personelit për realizimin sa më të mirë të detyrave.
- Inkurajimin aktiv të punonjesve për të përmirësuar dhe zhvilluar aftësitë tekniko-profesionale të tyre.
- Merr pjesë në studimet dhe analizat në fushën e TIK dhe propozon politika nxitëse dhe mbështetëse për zhvillimin e infrastrukturës së TIK.

Sektori i Financës dhe i Shërbimeve mbështetëse përbëhet nga:

- 1 (një) Përgjegjës sektori;
- 1 (një) Specialist (financë/buxhet);
- 2 (një) Specialist (burime njerëzore);
- 1 (një) Specialist Protokolli;
- 1 (një) Shofer;
- 1 (një) Pastrues;
- 1 (një) Magazinier.

3.2. Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse (ISHSH rajonal)

Ky sektor ka për qëllim të menaxhojë sistemin buxhetor të Degës Rajonale të ISHSH, ashtu si dhe është përgjegjës për menaxhimin e një administrate sa më të qëndrueshme, profesionale dhe efçente nëpërmjet:

- Krijimit të kushteve sa më të përshtatshme për administratën, të cilat inkurajojnë zhvillimin e personelit për realizimin sa më të mirë të detyrave.
- Inkurajimin aktiv të punonjesve për të përmirësuar dhe zhvilluar aftësitë tekniko-profesionale të tyre.
- Administron Dosjet, Regjistrin dhe Librezat e Punës të Personelit.
- Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse raporton me shkrim çdo muaj për ecurinë e punëve brenda sektorit pranë Kryeinspektorit të Degës Rajonale të ISHSH.

Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse (ISHSH rajonal) përbëhet nga:

- 1 (një) Përgjegjës sektori;
- 1 (një) Shofer;
- 1 (një) Punonjës mirëmbajtjeje

Gjatë vitit 2019 të ardhurat e ISHSH ishin 51 700 634 lekë.

- Planifikimi buxhetor për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative për Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, viti 2020

ZERI BUXHETIT	PLAN	FAKT
PAGA (600)	198 366 421	191 940 917
SIG.SHOQ. (601)	33 645 782	29 035 293
MALLRA ETJ. (602)	70 780 000	52 611 743
INVESTIME (230)	0	0

- Të ardhurat dytësore për Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, viti 2020

KLASIFIKIMI BUXHETOR	TE ARDHURA
AKT MIRATIME HIGJIENO SANITARE (7110199)	12 262 500
MASA ADMINISTRATIVE (7115499)	35 935 993

4. ARRITJET E INSPEKTORATIT SHTETËROR

Puna dhe aktiviteti i ISHSH gjatë vitit 2020 është kryer duke jetuar me pandeminë e COVID-19 dhe bazuar në përvojën më të mirë të institucionit tone në vite gjithmonë duke pasur në mendje krijimin dhe funksionimin e një institucioni që i përgjigjet kërkesave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe është në shërbim të tyre. Përveç detyrave funksionale, trupa inspektuese e ISHSH ka kryer kontrole të vazhdueshme për zbatimin e protokolleve të masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Pandemia e shkaktuar nga SARS-CoV-2 ishte një sfidë e madhe për Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor i cili gjatë gjithë periudhës e në vazhdim, duke mos ndërprerë punën as në kohën e karantinës, ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe kryesor, duke u përgjigjur në mënyrë efikase në të gjitha detyrat e tij funksionale të përcaktuar Ligji 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe në zbatim të të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Monitorime të përditshme të kushteve higjieno sanitare dhe shëndetësore në qendrat e akomodimit të qytetarëve të dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, monitorimi i ujit të pijshëm, monitorim i nyjeve hidrosanitare në subjektet me grumbullime të mëdha për parandalimin e sëmundjeve infektive, largimi i mbetjeve urbane, dezinfektimi i zonave pas largimit të inerteve dhe dokumentacioni shëndetësor dhe higjieno sanitar i personelit të shërbimit, duke shmangur dhe duke mos pasur asnjë rast shpërthimi të sëmundjeve infektive apo atyre me origjinë nga uji i pijshëm.
- Informimi dhe pajisja i të gjitha pikave doganore që më datën 1 shkurt 2020, me posterat paralajmërues për masat mbrojtëse që duheshin respektuar në lidhje me mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
- Kontrolli i temperaturës plotësimi i Formularit të Vlerësimit dhe Investigimit për udhëtarët që hyjnë në Shqipëri në pikat e kalimit kufitar ajror dhe detar.
- Inspektimi i Institucioneve të shërbimit shëndetësor publik që në ditët e para të pandemisë e në vazhdim duke identifikuar të gjitha mangësitë dhe marrjen e masave të sigurisë sipas protokolleve të miratuara.
- Inspektimi i kushteve higjieno sanitare, marrjen e masave anticovid dhe pajisjen me materialet e nevojshme për përballimin e situatës në institucionet arsimore parashkollore dhe shkollore duke minimizuar dhe duke patur raste të vogla të përhapjes së Covid-19 në këto institucione. Në bashkëpunim me NJVKSH u arrit që cdo institucion arsimor të ketë personel shëndetësor për kontrollin e përditshëm të nxënësve dhe të ketë të gjithë pajisjet e nevojshme për përballimin e situatës.
- Inspektimi i spitaleve, klinikave dhe laboratorëve jopublikë duke parandaluar kryerjen e analizave për Covid-19 pa miratimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke mbrojtur shëndetin e popullatës.
- Inspektimi i subjekteve me numër të madh punonjësish si Fasoneri/Call-Center, Fabrika prodhimi etj. për kontrollin e shëndetit në punë dhe praninë e personelit shëndetësor të detyrueshëm për kryerjen e të gjitha kontroleve apo plotësimin e dokumentacionit shëndetësor të përditshëm sipas protokollit të kuq. Të gjitha këto subjekte u pajisën me personel shëndetësor me kohë të plotë apo të pjesëshme sipas numrit të punonjësve.
- Përgjigja në kohë reale për të gjitha lajmerimet e kryera nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, për persona pozitivë për COVID-19, duke mbyllur cdo ambient apo subjekt, për të parandaluar përhapjen e infeksionit. Janë marrë një sërë Vendimesh të Ndërmjetme në subjektet me një numër të madh punonjësish dhe në Institucionet publike.

- Inspektimi i subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm duke arritur që kvtë vit të mos kishim asnjë rast të shpërthimit të sëmundjeve me origjinë hidrike. Bashkëpunimi me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit për ndalimin e tregtimit të ujit në mënyrë të paligjshme dhe në kushte jo të mira higjieno sanitare duke marrë një sërë masash administrative ndaj autoboteve të ujit.
- Hartimi i Listë-Verifikimeve të reja për kontrollin e zbatimit të masave anticovid sipas protokolleve të nxjerra nga Instituti i Shëndetit Publik dhe miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Bashkëpunimi me Inspektoratin Qendror për hedhjen e tyre në sistemin e-inspektimi.
- Inspektimi i subjekteve tregtare dhe detyrimi i tyre për zbatimin e masave anticovid dhe pajisjen e tyre me mjete mbrojtëse: xhamat mbrojtës, tunelin e dezinfektimit, termometrat infrared, barrierat e mbrojtjes personale, shenjat e distancimit, krijimin e distancave etj.
- Pjesëmarrja në Task Forcën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, krahas të gjitha institucioneve shëndetësore, si institucioni përgjegjës për inspektimin e të gjitha masave të vecanta sipas urdhërave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Komitetit Teknik.
- Pjesëmarrja në “Task Forcën për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, të drejtuar nga Kryeministri Edi Rama, si një nga institucionet kryesore për kontrollin në terren për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në njësitë tregtare të lejuara të ushtrojnë aktivitetin për periudhën e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
- Pjesëmarrje në grupin e punës për hartimin e specifikimeve të fotove dhe paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit në shëndet bazuar në Ligj nr. 9636, datë 06 nëntor 2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” të ndryshuar, bazuar në Urdhrin nr. 541, datë 24.07.2019 për “Ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e specifikimeve të fotove të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit në shëndet”.

5. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

Gjatë vitit 2021 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ISHSH, do të vazhdojë inspektimet në bazë të Programit të Inspektimeve 2021 të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dakordësuar nga Inspektorati Qendror.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ISHSH, është institucioni kryesor i ngarkuar për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, masa të cilat rrjedhin prej Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Objektivat të tjerë të ISHSH gjatë vitit 2021 do të jenë:

- Inspektime të vazhdueshme për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, masa të cilat rrjedhin prej Ligjit 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19
- Inspektimi i shërbimeve parësore shëndetësore publike dhe jo publike (pika ambulatorë, qendra shëndetësore, poliklinka shëndetësore, kabinet imazherik, kabinet dentar dhe shërbim laboratorik).
- Inspektimi i ndërmarrjeve për kujdesin dhe sigurinë e shëndetit në punë.
- Inspektimi i klinikave dhe laboratorëve stomatologjikë publike dhe jo- publike.
- Inspektimi i spitaleve publike dhe jo publike.
- Inspektime në institucione parashkollore, shkollorë, institucione të arsimit të lartë dhe subjekte të akomodimit.
- Inspektimet e kryera për akreditimin e institucioneve shëndetësore publike dhe jo-publike.
- Inspektimi i subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Inspektimet për zbatimin e ligjit 26/2017 “Për Produktet Kozmetike”.
- Inspektimi i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, IEVP, paraburgimit dhe ambienteve të ndalimit në Drejtoritë e Policisë dhe Komisariate
- Inspektimet e kryera për zbatimin e ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.
- Inspektimet e kryera për zbatimin e ligjit nr. Nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar”

Frekuenca e inspektimeve zyrtare të planifikuara është në parim e përcaktuar nga numri i subjekteve të inspektimit, d.m.th i subjekteve që veprojnë në fusha të ndryshme të shërbimeve ndaj qytetarëve që veprojnë në një vënd apo rajon, të ndara sipas madhësisë bazuar në indikatorë sasiorë dhe vlerësimin e riskut që kanë shërbimet (produkti) me të cilat operojnë këto subjekte.

Kjo do të thotë se për të përcaktuar numrin e inspektimeve vjetore për subjekt do të bazohemi në ndarjen si me poshtë vijon:

I. SUBJEKTE ME RISK TË MODERUAR TË CILAT DO TË INSPEKTOHEN 1 HERË NË VIT

- Kabinet Mjekësor jo publik do të inspektohen 1 herë në vit
- Qendër Mjekësore jo publike do të inspektohen 1 herë në vit
- Shërbimi laboratorikë mjekësor publik dhe jo publik do të inspektohen 1 herë në vit
- Kabinet Dentar jo publik do të inspektohet 1 herë në vit.
- Kabinet Dentare publik do të inspektohet 1 herë në vit
- Laboratorët Dentarë do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjekte akomodimi me fjetje (hotele, motele, hostele, bujtina, hane, resorte, fshatra turistike, kampingje) do të inspektohen 1 herë në vit
- Pishinat do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjektet social kulturore dhe sportive (muzetë, teatrot, kinematë, bibliotekat, palestrat, sallat e kërcimit, kampingje ditore, parqet kombëtare etj) do të inspektohen 1 herë në vit
- Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale (burgjet, paraburgimi) komisariatet e policisë do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjektet e inspektuara për sigurinë në punë do të inspektohen 1 herë në vit
- Shërbime Ndërhyrëse H-S do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjekte importuese të DDD do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjekte importuese të qumështit të gjirit do të inspektohen 1 herë në vit
- Bar (bar-kafe, bar-lloto, pub, disco etj) do të inspektohen 1 herë në vit

II. SUBJEKTE ME RISK TË LARTË TË CILAT DO TË INSPEKTOHEN 2 HERË NË VIT

- Spitalet publike do të inspektohen 2 herë në vit
- Spital jo publike do të inspektohen 2 herë në vit
- Poliklinikë publike do të inspektohen 2 herë në vit
- Qendër shëndetësore/pikë ambulatorë shëndetësore publike do të inspektohen 2 herë në vit
- Subjektet me veprimtari jonizuese që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, do të inspektohen gjatë gjithë vitit.
- Institucionet arsimore (cerdhe, kopshte, shkolla fillore, shkolla 9-vjecare, shkolla të mesme, universitete, konvikte universitare etj) do të inspektohen 2 herë në vit

III. SUBJEKTE ME RISK TË LARTË TË CILAT DO TË INSPEKTOHEN 3 HERË NË VIT

- Subjektet e furnizimit me ujë (burim uji, kaptazhe, depo uji, stacione pompimi, ujësjellës, puse etj) do të inspektohen 3 herë në vit.

6. TREGUESIT E EFEKTIVITETIT TË ISHSH GJATË VITIT 2020

SHTOJCA

- **BAZA LIGJORE E NXJERRE PER PER PERBALLIMIN E COVID-19.**
-
- **BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË ISHSH.**

BAZA LIGJORE E NXJERRE PER PER PERBALLIMIN E COVID-19.

AKTE NORMATIVE

- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”.
- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 16.3.2020 Për disa shtesa në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”.
- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 17.3.2020 Për një shtesë në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar
- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 24.3.2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar
- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 25.3.2020 Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 2.4.2020 Për një shtesë në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar
- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 11.4.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normative nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar
- Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 17.4.2020 Për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues të vendosura gjatë periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
